



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201301539/8

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2015

**Lënda:** *Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Kryetarit të Zyrës së Përmbarrimit Berat*

**Drejtuar :** Z. Albert PILO  
Drejtore i Përgjithshëm i Përmbarrimit

Tiranë

*I nderuar zoti Pilo,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetësja M.P.. Ankuesja ankohet ndaj Zyrës së Përmbarrimit Berat për moszekutimin e Vendimit nr. 9989, datë 18.11.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i ndryshuar me Vendimin nr. 603, datë 09.06.2011 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Me këtë vendim gjyqësor është vendosur:

*"Detyrimi i palës së paditurit, Inspektoriatit Shtetëror i Punës, të dëmshpërblejë paditësen Miranda Papa me 19 muaj pagë e llogaritur me pagën bruto në momentin e largimit nga puna në shumën 58000 lekë në muaj, në të cilën përfshihen 8 muaj pagë si dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënies së punës, me 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, me 3 muaj pagë për afatin e njoftimit dhe 6 muaj për vjetërsi në punë".*

Ankuesja pretendon se, Zyra e Përmbarrimit Berat nuk ka bërë të mundur ekzekutimin e titullit ekzekutiv ndonëse kërkesa e saj për vënien në ekzekutim e tij është bërë që në vitin 2011.

Në bazë të kërkesës tonë, ju me shkresën nr. 578/1 Prot., datë 08.07.2014, ndërmjet të tjerave na keni informuar se, përmbarruesja gjyqësore që ka ndjekur këtë çështje është larguar nga puna për moskryerje flagrante të procedurave përmbarrimore. Ndërsa përmbarruesi gjyqësor pranë të cilit ka kaluar kjo çështje ka vijuar me procedurat përkatëse ligjore për të bërë të mundur zbatimin e vendimit gjyqësor të cituar më lart.

Bazuar në nenin 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilën parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, në nenin 19, gërma b, të ligji nr. 8485, dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*; si dhe në nenin 19, paragrafi i fundit, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”*, me shkresat nr. K3/M38-6 Prot., datë 25.03.2015 dhe nr. K3/M38-7 Prot., datë 14.05.2015 i kërkuam Kryetarit të Zyrës së Përmbarrimit Berat që të dërgonit shpjegime lidhur me pretendimet e ankueses dhe veprimet që kjo zyrë ka bërë për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të cituar më sipër.

Ndonëse afatet ligjore të kthimit të përgjigjes së kërkesave tona kaluan, ai nuk na i dërgoi ato. Mosdërgimi i përgjigjes ka sjellë shumë vonesë në shqyrtimin e këtij rasti dhe moskorrektesën e institucionit tonë ndaj ankueses.

Ndërkohë nëpërmjet shkresës së fundit i kujtuam atij se detyrimi i organeve të administratës publike për të bashkëpunuar me institucionin e Avokatit të Popullit dhe për t’i kthyer përgjigje kërkesave të tij është parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj. Gjithashtu i bëmë të ditur se ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, në nenin 22/1 të tij parashikon edhe të drejtën e Avokatit të Popullit për të kërkuar masa disiplinore ndaj punonjësve të administratës publike të cilët nuk bashkëpunojnë me të.

Megjithatë, edhe pas kërkesës së dytë, ai përsëri nuk na e dërgoi përgjigjen e kërkuar nga ana jonë. Moskthimi i përgjigjes së kërkuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit është një nga rastet tipike të mosbashkëpunimit të punonjësve të administratës publike me institucionin tonë.

Ky qëndrim i Kryetarit të Zyrës së Përmbarrimit Berat me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankueses. Ndërkohë ai cënon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1 të ligjit *“Për Avokatin e Popullit”* ku parashikohet se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”*,

### **K Ë R K O J M Ë :**

1. Fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Kryetarit të Zyrës së Përmbarrimit Berat.

2. Ky rast të përgjithësohet dhe t’u bëhet i njohur gjithë drejtuesve të Zyrave Përmbarrimore në vend me qëllim që të mospërsëritet më në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë dhe masën disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**